

VENDIM
Nr. 81/2021

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR KONTROLLIN
E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË ORGANEVE PUBLIKE NË
PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTEVE TË
TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, të neneve 5, 6, 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar, me propozimin e një të katërtës së deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane. Ky hetim do të synojë nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, garantimin e transparencës, mbrojtjen e konkurrencës dhe tregut të lirë dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për një mjedis të pastër.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1. Kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ana e organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane.

2. Verifikimi i pasojave ekonomike në buxhetin e shtetit shqiptar, si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të organeve publike.

3. Verifikimi i efekteve mjedisore dhe pasojave mbi konkurrencën dhe tregun e lirë.

4. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave ligjore për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe parimit të mosdiskriminimit.

5. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave të përshtatshme ligjore për mbrojtjen e mjedisit.

6. Rekomandime për marrjen e masave të përshtatshme duke ndërgjegjësuar hallkat e administratës shtetërore mbi aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e mjedisit.

7. Vlerësimi i nevojës për përafrimin e legjislacionit për koncensionet dhe mjedisor, me direktivat dhe praktikat më të mira të BE-së.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, miratime, ndryshime apo korrigjime të kuadrit ligjor dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për fillimin e çështjes penale.

V. Komisioni hetimor përbëhet nga 15 anëtarë si më poshtë:

1. Jorida Tabaku	kryetare	PD
2. Ermonela Felaj	zëvendëskryetare	PS
3. Arben Pëllumbi	anëtar	PS
4. Eduard Shalsi	anëtar	PS
5. Etjen Xhafaj	anëtar	PS

6. Anila Denaj	anëtare	PS
7. Fadil Nasufi	anëtar	PS
8. Antoneta Dhima	anëtare	PS
9. Besion Ajazi	anëtar	PS
10. Edmond Spaho	anëtar	PD
11. Helidon Bushati	anëtar	PD
12. Dhurata Çupi	anëtare	PD
13. Belind Këlliçi	anëtar	PD
14. Luçiano Boçi	anëtar	PD
15. Lefter Gështhenja	anëtar	PD

1. Jurgis Çyrbja	anëtar zëvendësues	PS
2. Denis Deliu	anëtar zëvendësues	PS
3. Luan Baçi	anëtar zëvendësues	PD
4. Ina Zhupa	anëtare zëvendësuese	PD

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që të caktojë menjëherë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhërave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 28.10.2021.